



Politika LOKALE për Energjinë E GJELBËR – LOCAL4GREEN

Prioriteti 2: Fuqizimi i strategjive për efikasitetin e energjisë dhe për karbon të ulët në territore të caktuara MED: qyte, ishuj dhe zona të largëta

Objektivi Specifik 2.2: Rritja e përdorimit të burimeve lokale të energjisë së rinovueshme në zona të caktuara MED

UDHËZUES I MODELEVE PËR POLITIKA FISKALE VENDORE TË GJELBËRA

Shqipëri



Tabela e Përmbajtjes

1.	Hyrje	5
1.1.	Informacion i Përgjithshëm për Projektin	5
1.2.	Kohëzgjatja.....	6
1.3.	Bashkëfinancimi	6
1.4.	Partnerët.....	7
2.	Shqipëria, si pjesë e MED	9
3.	Udhëzues për modele të politikave fiskale lokale të gjelbra	11
3.1.	Objektivat.....	11
3.2	Grupet e synuara.....	11
4.	Kuadri ligjor vendas për politikat fiskale vendore	13
4.1.	Taksat e ndara	14
4.1.1	Taksa mbi qarkullimin e automjeteve të përdorura	14
4.1.2.	Renta minerale	15
4.1.3	Tatimi mbi të ardhurat personale	15
4.2	Taksat vendore.....	16
4.2.1	Taksa vendore mbi veprimtarinë ekonomike të biznesit të vogël	17
4.2.2	Taksa mbi pasurinë e paluajtshme	17
4.2.3.	Taksa e fjetjes në hotel.....	19
4.2.4	Taksa e ndikimit në infrastrukturë	19
4.2.5	Taksa e tabelës	20
4.2.6	Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	20



Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

4.2.7	Taksat e përkohshme vendore	20
4.3	Tarifat vendore.....	21
4.3.1	Tarifa për zënien e hapësirës publike dhe të fasadave.....	21
4.3.2	Tarifa e shërbimeve publike	22
4.3.3	Tarifa për shërbime administrative	23
4.4	Vëzhgim i përgjithshëm mbi buxhetin e bashkive	23
5	Modele të politikave fiskale të gjelbra në bashkitë pilote	25
5.1	Bashkia Lezhë	25
	Profili i përgjithshëm.....	25
	Politikat fiskale të propozuara	27
	Vlerësim i ndikimit financiar të masave fiskale	27
	Vlerësimi i energjisë së kursyer dhe gazrat që nuk do të emetohen.....	30
5.2	Bashkia Vau i Dejës	33
	Profili i përgjithshëm.....	33
	Politikat fiskale të propozuara	35
	Vlerësimi i energjisë së kursyer dhe gazrat që nuk do të emetohen.....	38
5.3	Bashkia Kukës.....	40
	Profil i Përgjithshëm	40
	Politikat fiskale të propozuara	42
	Vlerësimi i energjisë së kursyer dhe gazrat që nuk do të çlirohen	44
6	Mjetet e verifikimit për kategoritë përfituese	45
	Për uljen e Taksës së Pronës (ndërtesë)	45
	Për lehtësim në tarifën e shërbimeve publike:	46
	Për parkim falas në hapësirat publike.....	46



Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

7	Komunikimi me Komunitetin	47
8	Përfundime.....	47



1. Hyrje

1.1. Informacion i Përgjithshëm për Projektin

Projekti LOCAL4GREEN, i financuar nga Programi Interreg MED, mbështet autoritetet lokale për të hartuar, miratuar dhe zbatuar politika lokale fiskale, inovative dhe të destinuar për të promovuar burimet e ripërtëritshme të energjisë në të gjithë sektorët (publik, privat, familjar) kryesisht në kuadër të SEAP (Plane Veprimi për Energji të Qëndrueshme sipas Konventës 2020) dhe SECAP (Planet e Energjisë së Qëndrueshme dhe Plani i Veprimit Klimatik që do të dorëzohen sipas Konventës 2030) të miratuara nga nënshkruesit e Paktit të Kryetarëve.

Projekti adreson Aksin 2 të Prioritetit: Fuqizimi i strategjive për efikasitetin e energjisë dhe për karbon të ulët në territore të caktuara MED: qyete, ishuj dhe zona të largëta dhe Objektivin Specifik 2.2: Rritja e përdorimit të burimeve lokale të energjisë së rinovueshme në zona të caktuara MED. Në këto lloj territorësh, ku autoritetet lokale kanë kufizime ekonomike dhe teknike, planet promovuese të burimeve të ripërtëritshme të energjisë duhet t'i japin prioritet bashkëpunimin dhe rolit aktiv midis sektorëve publikë dhe privatë.

Projekti ka pilotuar aktivitete në autoritetet lokale të 9 shteteve / rajoneve të zonës MED (Spanjë, Portugali, Itali, Qipro, Maltë, Greqi, Slloveni, Shqipëri dhe Kroaci), ku politikat fiskale lokale luajnë një rol vendimtar për të rritur pjesën e burimeve të ripërtëritshme të energjisë.

Aktivitetet pilote përfshijnë hartimin me pjesëmarrje, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave fiskale lokale për promovimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë.

Përveç kësaj, projekti do të mundësojë kapitalizimin e praktikave më të mira dhe zbatimin në bashkitë e tjera, në nivele kombëtare dhe ndërkombëtare, pasi modelet e politikave fiskale lokale të gjelbra do të përpunohen dhe shpërndahen duke siguruar dhe mbështetje teknike. Në këtë mënyrë, projekti do t'u sigurojë autoriteteve vendore mbështetje që modelet e politikave fiskale të përfshihen në strategjitë dhe planet e tyre.

Aktivitetet e planifikuara për këtë projekt janë renditur më poshtë:



Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

-
- Hartimi i metodologjisë me pjesëmarrje për përgatitjen e politikave të gjelbërta fiskale vendore për promovimin e burimeve të rinovueshme të energjisë;
 - Ngritja e një platforme online me të dhënat publike mbi ndikimin e projektit;
 - Hartimi dhe zbatimi i politikave fiskale lokale për promovimin e burimeve të rinovueshme të energjisë;
 - Prgatitja e mjeteve për transferimin e politikave fiskale lokale për të nxitur burimet e ripërtëritshme të energjisë;
 - Zbatimi i planit për transferimin e politikave lokale fiskale të gjelbra;
 - Zbatimi i planit ndërkombëtar të transferimit të politikave fiskale të gjelbërta.

Pasi të përfundojnë fazat e hartimit, zbatimit dhe monitorimit të politikave fiskale, si dhe vlerësimit të aktiviteteve pilote dhe politikave fiskale, secili partner do të hartojë një udhëzues kombëtar mbi modelet e politikave fiskale të gjelbra lokale.

Ky dokument është udhëzuesi kombëtar për bashkitë e Shqipërisë. Udhëzuesi kombëtar do të përdoret nga fondacioni MUSOL për të përgatitur udhëzuesin ndërkombëtar mbi modelet e politikave fiskale të gjelbra lokale.

Udhëzuesi nuk ka për qëllim të jetë shterues përse i përket detyrave dhe nismave që duhen kryer nga partnerët, por ka si qëllim të ofrojë një pasqyrë të detyrave dhe sfidave më të shpeshta në punën e Shoqatës së Bashkive dhe me shpresë që të arrihet objektivi i komunikimit dhe ndarjes së përvojës dhe praktikës së mirë me të gjitha rajonet evropiane.

1.2. Kohëzgjatja

Projekti ka një kohëzgjatje prej 1 nëntorit 2016 deri në 31 tetor 2019.

1.3. Bashkëfinancimi

Projekti LOCAL4GREEN lidhet me zbatimin e politikave të gjelbra dhe në veçanti taksimit të gjelbër në njësitë e qeverisjes vendore të Evropës për financimin dhe promovimin më të gjerë të sistemeve të burimeve të energjisë së rinovueshme në territorin e tyre.



Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

Projekti ka një buxhet total prej 2,013,423.15 €. Përqindja e bashkëfinancimit është 85%, kështu që kontributi i Programit Interreg MED në projekt është 1,711,409.70 €.

Bashkëfinancimi vjen nga Fondi Europian i Zhvillimit Rajonal, përveç në rastin e Shqipërisë, që vjen nga fondet e Instrumentit të Ndhmës së Para-Anëtarësimit.

1.4. Partnerët

Projekti po zbatohet në 9 shtete të zonës MED, të cilët janë Shqipëria, Kroacia, Qiproja, Greqia, Italia, Malta, Portugalia, Sllovenia dhe Spanja.

Partnerët e projektit janë:

- Federata Valenciane e Bashkive dhe Provincave (VFMP), Partneri kryesor, Spanjë;
- Fondacioni MUSOL (MUSOL), Spanjë;
- Agjencia e Menaxhimit të Energjisë Inteligjente në Maltë, MIEMA;
- Agjencia Rajonale e Energjisë e Kroacisë Veri-Perëndimore, REGEA;
- Agjencia e Zhvillimit të Autoriteteve Lokale të Selanikut Lindor, Qendra për Zhvillimin e Burimeve Njerëzore dhe Mbështetja e Ekonomisë Lokale (ANATOLIKI S.A), nga Greqia;
- Shoqata Kombëtare e Bashkive Italiane - Lazio (ANCI LAZIO), nga Italia;
- Instituti i Inxhinierisë Civile ZRMK (GI ZRMK), nga Sllovenia;
- Agjencia e Energjisë së Qipros (CEA);
- Universiteti Algarve (UAlg), nga Portugalia;
- Shoqata e Bashkive të Shqipërisë (AAM), nga Shqipëria.



Shoqata e Bashkive të Shqipërisë



Figura 1 Partnerët e LOCAL4GREEN

Partnerë të Asociuar të LOCAL4GREEN janë:

- Agjencia e Zhvillimit Gozo – Komiteti Rajonal Gozo (GDA) – Maltë;
- Bashkia Kamnik – Slloveni;
- Agjencia Lokale e Energjisë së Gorjenska – Slloveni;
- Bashkia Kocevje – Slloveni;
- Agjencia Rajonale e Energjisë dhe Mjedisit të Algarve (AREAL) – Portugali;
- Bashkia Loulé – Portugali;
- Bashkia Faro – Portugali;
- Qendra për Kërkim për Energjinë e Rinovueshme - – Universiteti Tuscia (CIRDER) – Itali;
- Komuna Formello – Itali;
- Komuna Olevano Romano – Itali;
- Qendra e Biznesit Inovator Valencia – Spanjë;
- Këshilli Komunitar Lythrodontas - Qipro;
- Bashkia Nicosia – Qipro;



Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

- Bashkia Aradippou – Qipro;
- Bashkia Thermi – Greqi;
- Konsorcium Ribera (RIBERA) – Spanjë.

2. Shqipëria, si pjesë e MED

Shqipëria shtrihet në Evropën Juglindore, në Perëndim të Gadishullit Ballkanik, me një sipërfaqe prej 28.748 km², me gjatësi të vijës kufitare 1094 km, nga të cilat 657 km janë vijë kufitare tokësore dhe 316 km vijë bregdetare, si dhe 48 km janë vijë ndarëse e lumenjve dhe 73 km e liqeneve.

Shqipëria kufizohet në jug dhe jug-lindje me Greqinë, në veri me Malin e Zi, në perëndim me Italinë, më të cilën ndahet nga deti Adriatik dhe deti Jon, në lindje me Maqedoninë e Veriut dhe në veri-lindje me Kosovën.

Sipas nenit 13 të Kushtetutës, qeverisja vendore "bazohet në parimin e decentralizimit të pushtetit dhe ushtrohet sipas parimit të autonomisë lokale". Në pjesën e gjashtë për qeverisjen vendore, (nenet 108 deri 115), Kushtetuta thekson se komunat ose bashkitë dhe qarqet janë njësitë e qeverisjes vendore. Shqipëria ka një qeverisje vendore të përbërë nga 12 qarqe dhe 61 bashki.

Organi vendimmarrës i bashkisë është këshilli bashkiak ndërsa pushteti ekzekutiv përfaqësohet nga kryetari i bashkisë. Këshilltarët dhe kryetari zgjidhen me votim të drejtpërdrejtë për një mandat katërvjeçar.

Qarqet nuk janë subjekte të plota vetëqeverisëse pasi ato nuk zgjidhen drejtpërdrejt, por dalin nga bashkitë e tyre përbërëse. Megjithatë, ata kanë buxhetin dhe administratën e tyre, edhe pse me përgjegjësi të kufizuara. Bashkitë delegojnë anëtarë në këshillin e qarkut në proporcion me popullsinë e tyre. Kryetarët e bashkive janë gjithmonë anëtarë të këshillit të qarkut. Anëtarët e tjerë zgjidhen nga këshilltarët bashkiakë.

Pas aplikimit të saj për anëtarësim në BE në vitin 2011, Shqipëria ndërmorri iniciativa të reja për të avancuar procesin e decentralizimit, duke përfshirë reformën territoriale dhe administrative në vitin 2014 (Ligji Nr. 115/2014 "Për Ndarjen Administrativo-Territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë", Strategjinë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015-



Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

2020 dhe Ligjin e ri për Vetëqeverisjen Vendore nr. 139/2015 i cili detajon më tej organizimin dhe funksionimin e njësive vendore.

Së fundi, një hap tjetër drejt decentralizimit u shënua në 2017 me miratimin e ligjit të ri për financat vendore nr. 68/2017. Ky ligj i ri është ligji i parë gjithpërfshirës për financat e pushtetit lokal që sjell të gjitha parimet dhe procedurat në lidhje me burimet e të ardhurave të qeverisë lokale, menaxhimin e shpenzimeve dhe dialogun dhe konsultimin ndërqeveritar të lidhur me to.

Reforma territoriale e vitit 2014 reduktoi numrin e NJQV-ve nga 373 (308 komuna dhe 65 bashki) në 61 bashki të reja. Madhësia mesatare e bashkive në terma të popullsisë u rrit nga 8 700 banorë në 47 150. Ka ende një mospërputhje të madhe midis bashkive të reja, nga bashkia më e vogël me 3 290 banorë deri tek Tirana me 763 297 banorë në vitin 2017. Bashkitë ndahen në njësi administrative që kanë lidhje tradicionale, historike, ekonomike dhe shoqërore, të gjitha prej tyre janë ish-komuna dhe bashki. Njësitë administrative përfshijnë qytetet (qytete) dhe fshatrat (fshatra). Qytetet mund të ndahen më tej në lagje (lagje). Deri më tani, 61 bashki përfshijnë 72 qytete dhe 2995 fshatra. Administrata e këtyre njësive është pjesë e administratës bashkiake dhe drejtohet nga një administrator, i emëruar dhe i shkarkuar nga kryetari i bashkisë.

Qarqet si pjesë e pushtetit vendor u krijuan në vitin 2000. Madhësia mesatare e tyre është 240 000 banorë, por ka dallime të mëdha mes tyre nga Gjirokastra me 66 000 banorë tek Tirana me më shumë se 860 000 banorë, përkatësisht 30% të popullsisë kombëtare. Qarku i Tiranës pasohet nga tre qarqet e Durrësit, Elbasanit dhe Fierit.

Nga 61 bashki, 17 prej tyre janë kufitare dhe 11 kanë dalje në det, e megjithatë zhvillimi ekonomik dhe turizmi malor apo bregdetar lë shumë për të dëshiruar.

Per tu vendosur harta

Figura – Harta administrative e Shqipërisë.

Projekti LOCAL4GREEN në Shqipëri është përqendruar në tre bashki pilote, Lezha, Vau i Dejës dhe Kukësi. Rezultate të arritura në këto bashki do të shpërndahen nga Shoqata e Bashkive në të gjitha bashkitë e tjera.



3. Udhëzues për modele të politikave fiskale lokale të gjelbra

Udhëzuesi Kombëtar për modelet e politikave fiskale lokale të gjelbra është një dokument përmbledhës i punës që është kryer nga Shoqata e Bashkive të Shqipërisë si partner i projektit me bashkitë pilote.

Ky dokument për modelet e politikave të gjelbra fiskale lokale synon të përmbledhë politikat fiskale lokale të gjelbra që janë hartuar në bashkëpunim me projektin dhe më pas janë miratuar nga bashkitë pilote. Burimet kryesore të informacionit për hartimin e këtij dokumenti janë raportet e vlerësimit të politikave fiskale si dhe të dhënat e marra nga bashkitë.

Udhëzuesit e përgatitur nga secili partner i projektit do të përmbledhen në një udhëzues ndërkombëtar, në mënyrë që të sigurohet mbështetje për bashkitë e tjera që kanë interes në zbatimin e politikave të reja fiskale lokale që synojnë të promovojnë burimet e ripërtëritshme të energjisë.

3.1. Objektivat

Objektivat e udhëzuesit kombëtar mbi modelet e politikave të gjelbra fiskale lokale janë:

- Përshkrimi i modeleve të politikave të transferueshme në nivel kombëtar, bazuar në përvojat dhe praktikën më të mira të pilotëve.
- Ofrimi i të gjitha të dhënave (ligjore, ekonomike, teknike, etj) të nevojshme për të zbatuar këto modele në bashkitë e tjera.
- Përfshirja në udhëzuesin ndërkombëtar të praktikave më të mira për politikat fiskale lokale të gjelbra.

3.2 Grupet e synuara

Për të arritur objektivat e tij, grupet e synuara të këtij dokumenti janë:

- Punonjësit dhe vendimmarrësit e njësive vendore;
- Ekspertë lokalë të menaxhimit publik;



Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

- Institucione kombëtare dhe rajonale;
- Aktorë të tjerë të interesuar në avokimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë në nivel lokal.



4. Kuadri ligjor vendas për politikat fiskale vendore

Burimet e disponueshme për njësitë e qeverisjes vendore në Shqipëri, dhe realisht në çdo vend, janë të kufizuara për të përmbushur të gjitha nevojat dhe prioritetet e komunitetit vendor. Me kalimin e kohës këto burime shtohen meqenëse njësitë e qeverisjes vendore përmirësojnë menaxhimin e taksave dhe të tarifave vendore. Edhe reformat periodike të miratuara mund të sigurojnë burime të reja financimi për njësitë e qeverisjes vendore.

Fakti është, sidoqoftë, se burimet e qeverisjes vendore do të jenë gjithmonë të kufizuara në raport me nevojat dhe prioritetet e komunitetit vendor, por aftësia e një qeverisje vendore është të gjejë ekuilibrin e përshtatshëm për të balancuar nivelet e shërbimeve dhe gatishmërinë e qytetarëve për të paguar.

Sigurimi i autonomisë financiare është një parim i garantuar nëpërmjet kushtetutës dhe dispozitave të tjera ligjore, duke përfshirë Ligjin nr. 9632/2006 për Taksat Vendore, Ligjin nr. 9896/2008 për huamarrjen vendore dhe ligjin e ri 68/2017 për financat lokale. Ky ligj i ri, i miratuar në prill 2017, tregon se decentralizimi fiskal mbetet një pjesë thelbësore e axhendës së reformave.

Të ardhurat e bashkive nga taksat përbëhen nga taksat e ndara dhe taksat vendore. Taksat e ndara përfshijnë 18% të taksës së automjeteve, 97% të të ardhurave nga kalimi i të drejtës së pronësisë, 25% të të ardhurave nga tatimi i qarkullimit të automjeteve të përdorura, 5% të të ardhurave nga renta minerale dhe 2% të të ardhurave të të ardhurave personale.

Të ardhurat nga taksat lokale përfshijnë taksën mbi pronën e paluajtshme, tatimin mbi biznesin e vogël dhe të tjera. Taksa mbi pronën është taksa më e rëndësishme vendore. Taksat e tjera lokale janë taksa mbi ndikimin në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, taksa e tabelës, taksa mbi donacionet, trashëgiminë dhe llotaritë lokale.

Bashkitë mund të mbledhin tarifa për shërbimet publike. Tarifat duhet të orientohen drejt mbulimit të kostos së shërbimeve të ofruara, konsumi i të cilave është i matshëm. Tarifat kryesore lidhen me zënien e hapësirës publike, mbledhjen dhe largimin e mbeturinave, furnizimin me ujë dhe kanalizimet, ujitjen dhe kullimin, licencat dhe lejet dhe autorizimet.

Më poshtë do të përshkruajmë të gjitha llojet e taksave dhe tarifave vendore.



4.1. Taksat e ndara

Taksat e ndara në kontekstin e legjislacionit shqiptar janë ato taksa kombëtare, një pjesë nga të ardhurat e të cilave shkojnë me ligj në buxhetin e pushtetit vendor. Administratori i kësaj takse transferon përqindjen e përcaktuar me ligj për llogari të qeverisjes vendore, por vetëm pasi është paguar nga tatimpaguesi. Bashkia është e lirë të përdorë këtë shumë për nevojat e veta.

Ky kapitull paraqet taksat e shpërndara kombëtare të referuara në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" të ndryshuar, Ligjin 68/2017 « Për Financat Vendore» duke marrë parasysh ndryshimet në Projektbuxhetin e vitit 2019.

Taksat kombëtare që ndahen me njësitë e qeverisjes vendore përfshijnë:

1. Taksa mbi qarkullimin e automjeteve të përdorura;
2. Renta minerale;
3. Tatimi mbi të ardhurat personale.

4.1.1 Taksa mbi qarkullimin e automjeteve të përdorura

Kjo taksë caktohet sipas formulës:

Cilindrata në cm³ x koeficienti fiks sipas vjetërsisë x taksa fikse për llojin e karburantit.

Taksa fikse për llojin e karburantit është 12.5 lekë për naftën dhe 10 lekë për benzinën. Mjetet me vjetërsi nga 0-3 vjet nuk janë subjekt i kësaj takse.

Të ardhurat nga taksa dhe gjobat për çdo rast, mblidhen nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor. Të ardhurat nga kjo taksë shpërndahen sipas procedurave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, nga të cilat, 5% strukturave të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, 25% buxhetit të qeverisjes vendore dhe pjesa tjetër Buxhetit të Shtetit.



Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

4.1.2. Renta minerale

Kjo taksë paguhet nga çdo person fizik ose juridik i liçencuar që operon në industrinë minerare. Sipas një marrëdhënie kontraktuale me Ministrin përgjegjës për ekonominë, ky subjekt duhet të paguajë rentën minerare për burimet natyrore që nxjerr në territorin e Republikës së Shqipërisë. Renta minerare llogaritet si detyrim mujor i tatimpaguesit. 5 përqind e të ardhurave nga renta minerare i takon bashkisë ku zhvillohet veprimtaria. Të ardhurat nga renta minerare përdoren për investime për njësitë e qeverisjes vendore.

Në rastin kur aplikohet renta minerare në përqindje, kjo taksë llogaritet duke shumëzuar vlerën e produktit (pa TVSH) me përqindjen e rentës. Kur zbatohet renta bazuar në një çmim të caktuar, shuma e saj llogaritet duke shumëzuar sasinë e shitjes së produktit me vlerën e rentës minerare.

4.1.3 Tatimi mbi të ardhurat personale

Tatimi mbi të ardhurat personale llogaritet mbi të ardhurat e individëve. Individët rezidentë janë përgjegjës për tatimin mbi të ardhurat personale gjatë periudhës tatimore për të gjitha burimet e të ardhurave.

Individët jorezidentë i nënshtrohen detyrimit të tatimit mbi të ardhurat personale gjatë periudhës tatimore për burimet e të ardhurave të realizuara në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Të ardhurat e tatueshme për individët përfshijnë:

- pagat dhe shpërblimet e tjera, në lidhje me marrëdhëniet aktuale të punës;
- të ardhurat që rrjedhin nga fitimi i ortakut apo i aksionerit në shoqërinë tregtare;
- të ardhurat nga interesat bankare apo ato të përfituara nga letrat me vlerë;
- të ardhurat që rrjedhin nga e drejta e autorit dhe pronësia intelektuale;
- të ardhurat nga enfiteoza, huaja dhe qiratë;
- të ardhurat nga kalimi i së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme;
- të ardhurat e individëve nga lojërat e fati dhe kazinotë;
- të ardhurat e realizuara nga diferenca ndërmjet çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes së kuotave ose aksioneve, që një ortak ose aksioner zotëron dhe ja shet një personi tjetër;



Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

-
- të ardhurat në formë monetare për shtimin e kapitalit me burime nga jashtë shoqërisë, që nuk janë të tatuara më parë, ndërkohë që kanë qenë objekt tatimi dhe që nuk janë të shoqëruara me dokumente zyrtare, që vërtetojnë origjinën e këtyre të ardhurave. Procedurat përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave;
 - të ardhura të tjera, që nuk identifikohen në format e paraqitura.

Bazuar në Ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes lokale", neni 25 pika 2, të ardhurat e mbledhura nga Drejtoria Rajonale e Taksave për tatimin mbi të ardhurat personale do të ndahen me njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe 2% të të ardhurave nga kjo taksë kombëtare ajo kalon në bashki.

Ndikimi i secilës prej këtyre taksave në buxhetin e bashkisë është përmbledhur në paragrafin e mëposhtëm:

- a) Nga taksa vjetore për qarkullimin e automjeteve të përdorura, 25% shkon në buxhetin e bashkive.
- b) Nga renta minerare, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për taksat kombëtare, 5% e të ardhurave shkojnë në buxhetin lokal.
- c) 2% nga të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale shkojnë në buxhetin lokal.

Të ardhurat e mbledhura nga taksat e veçanta transferohen në njësitë e vetëqeverisjes lokale deri në fund të muajit pasardhës.

4.2 Taksat vendore

Me përjashtim të rasteve kur në ligj përcaktohet shprehimisht ndryshe, bashkia, nëpërmjet këshillit bashkiak bën kategorizime më të hollësishme, në përputhje me kushtet dhe interesat vendore, brenda kategorive minimale të bazës së taksës, vendos për nivelin e taksës brenda kufijve të përcaktuar në ligj, dhe përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale.

Në taksat vendore përfshihen:



Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

1. Taksa vendore mbi veprimtarinë ekonomike të biznesit të vogël;
2. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat, taksa mbi tokën bujqësore dhe taksa mbi truallin;
3. Taksa e fjetjes në hotel;
4. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja;
5. Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme;
6. Taksa e tabelës;
7. Taksa të përkohshme

4.2.1 Taksa vendore mbi veprimtarinë ekonomike të biznesit të vogël

Çdo subjekt, i cili kryen një biznes, me anë të të cilit realizohet gjatë vitit fiskal qarkullim më i vogël ose i barabartë me 8 000 000 (tetë milionë) lekë, i nënshtrohet detyrimit të pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël. Të ardhurat gjithsej nga veprimtaria e biznesit të vogël nënkuptojnë çdo lloj të ardhure, të realizuar gjatë periudhës tatimore dhe përfshijnë, pa u kufizuar vetëm në to: të ardhurat e realizuara nga furnizimi i mallrave dhe shërbimeve, të ardhurat nga pjesëmarrjet, të ardhurat nga interesat, të ardhurat nga shfrytëzimi i pasurisë së luajtshme e të paluajtshme.

Shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshëm, për tatimpaguesit që i nënshtrohen tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, me qarkullim vjetor nga 2 deri në 8 milionë lekë, është 7.5 për qind. Bizneset me xhiro deri në 2 milionë lekë nuk paguajnë tatimfitimi, por një taksë të thjeshtuar.

Administrata Tatimore Qendrore transferon të ardhurat nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël në llogari të bashkive ku ka vendndodhjen biznesi i taksueshëm, brenda datës 10 të muajit pasardhës, kur janë arkëtuar tatimet.

4.2.2 Taksa mbi pasurinë e paluajtshme

Në taksat mbi pasurinë e paluajtshme përfshihen:

- a) taksa mbi ndërtesat;
- b) taksa mbi tokën bujqësore;
- c) taksa mbi truallin.



Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

Taksat llogariten si detyrim vjetor i taksapaguesit. Nëse pasuria e taksueshme krijohet, tjetërsohet ose zhduket brenda kësaj periudhe, detyrimi i taksapaguesit llogaritet proporcionalisht vetëm për periudhën e të drejtës së pronësisë. Këshilli bashkiak vendos për nivelin e taksës, që do të zbatohet për çdo kategori minimale të bazës së taksës, në kufijtë plus-minus 30 për qind të nivelit tregues të taksës për kategorinë përkatëse.

Taksa mbi ndërtesat

Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen individët, personat fizikë ose juridikë, vendës apo të huaj, pronarë ose përdorues të pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave, përveç rasteve kur në këtë ligj përcaktohen ndryshe.

Shkalla e taksës mbi ndërtesat, e cila aplikohet si përqindje e bazës së taksës, është si më poshtë:

- a) 0,05% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për banim;
- b) 0,2% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike;
- c) 30% e shkallës së taksës përkatëse për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

Taksa mbi tokën bujqësore

Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi në përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i tokës bujqësore bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së tokës bujqësore, pranë bashkisë ku ndodhet toka. Për çdo kategori minimale të tokës bujqësore, këshilli bashkiak mund të miratojë nënkategorizime. Niveli i taksës caktohet në lekë për hektar. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme. Përfshihen nga taksat tokat bujqësore, që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes. Taksat e mbledhur në mbështetje të këtij ligji paguhet në buxhetin e bashkisë në territorin e së cilës ndodhet prona e taksueshme.

Kategoritë e tokës bujqësore	1	2	3	4
I	5 600	4 200	2 800	1 400



Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

II	4 900	3 500	2 100	1 200
III	4 200	2 800	1 400	1 100
IV	3 600	2 300	1 350	1 000
V	3 000	1 900	1 250	900
VI	2 400	1 600	1 200	800
VII-X	1 800	1 400	1 100	700

Tabelë: Vlera e taksës në LEK/vit/ha të tokës bujqësore

Taksa mbi truallin

Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit, në metër katror, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim, pranë bashkisë ku ndodhet trualli. Për çdo kategori minimale të truallit, këshilli bashkiak mund të miratojë nënkategorizime. Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme. Taksa e mbledhur, në mbështetje të këtij ligji, paguhet në buxhetin e bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet prona e taksueshme.

4.2.3. Taksa e fjetjes në hotel

Baza e taksës së hotelit është çmimi i fjetjes, sipas rastit për dhomë ose për person, për një natë. Shkalla tatimore është deri në 5% të çmimit të fjetjes. Detyrimi tatimor llogaritet si shkalla tatimore e caktuar nga bashkia për çmimin e fjetjes dhe numrin e netëve në hotel. Detyrimi tatimor i takon klientit që strehohet në hotel, një detyrim që merr hoteli në emër të bashkisë në territorin e së cilës ndodhet. Në faturën e hotelit shkruhet çmimi i fjetjes dhe vlera e taksës.

4.2.4 Taksa e ndikimit në infrastrukturë

Baza e kësaj takse është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet. Klasifikimi si një investim i ri dhe vlerat përkatëse përcaktohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit. Shkalla tatimore është shprehur si përqindje e vlerës së investimit dhe është 1 deri 3 për qind e kësaj vlere, me përjashtim të Bashkisë së Tiranës ku vlera është 2 deri 4 për qind e vlerës së investimit. Për ndërtesat



Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

që janë në proces të legalizimit, ndikimi në infrastrukturën e ndërtimeve të reja është 0.5 përqind e vlerës së investimit. Detyrimi për këtë taksë i përket investitorit.

4.2.5 Taksa e tabelës

Taksa e tabelës zbatohet për të gjitha subjektet, të cilat vendosin tabela, të lëvizshme apo të palëvizshme, për të identifikuar veprimtarinë e tyre ose për qëllime reklamimi të veprimtarisë së tyre apo dhe për të tretë, që vendosen në pamjen ballore të vendndodhjes së veprimtarisë, ose brenda territorit të përbashkët në qendrat tregtare, ose në hapësira jashtë vendndodhjes së veprimtarisë, qofshin këto publike ose private.

Vendosja e tabelës për qëllim identifikimi është detyrim për të gjithë subjektet, me përjashtim të ambulanteve. Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit harton planin për vendosjen e mundshme të tabelave për qëllime reklamimi, të thjeshta dhe elektronike.

4.2.6 Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme

Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë e paluajtshme në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to. Taksa paguhet nga personi, që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

Baza e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës transferohet. Baza e taksës për kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e tjera të paluajtshme është vlera e shitjes së tyre. Niveli i taksës përcaktohet në përqindje dhe niveli tregues i taksës është 2%. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.

Vjelja e kësaj takse bëhet nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të cilat, në rolin e agjentit të taksave, përfitojnë 3 përqind të shumës së arkëtuar dhe diferencën e derdhit për llogari të buxhetit përkatës të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet pasuria, jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës.

4.2.7 Taksat e përkohshme vendore

Këshilli bashkiak kur e gjykon të domosdoshme, vendos taksa me karakter të përkohshëm, në interes të përgjithshëm të komunitetit, në territorin brenda juridiksionit të tij. Baza e llogaritjes së taksës së përkohshme për çdo tatimpagues është vlera e taksës së pasurisë së paluajtshme të tatimpaguesit në territorin e njësisë së vetëqeverisjes vendore. Niveli i taksës së përkohshme nuk mund të jetë më i lartë se 35 përqind e bazës së taksës së pasurisë së paluajtshme të tatimpaguesit. Taksa e përkohshme nuk mund të zbatohet për më shumë se tre vjet nga hyrja në fuqi.



Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

Të ardhurat nga taksa e përkohshme mund të shpenzohen vetëm për qëllimet e përcaktuara në vendimin e këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore që miraton taksën dhe nuk mund të konsiderohen si të ardhura korrente në llogaritjen e kufijve të borxhit të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Njësitë e vetëqeverisjes vendore nuk mund të aplikojnë me shumë se dy taksa të përkohshme gjatë një viti buxhetor.

4.3 Tarifat vendore

Tarifë vendore është një pagesë që një individ, person fizik apo juridik bën në shkëmbim të një shërbimi specifik të marrë, të mirë publike specifike të përdorur apo të drejte të dhënë nga njësi e vetëqeverisjes vendore. Niveli i tarifës orientohet në mbulimin e kostos së shërbimit publik të ofruar nga njësi e vetëqeverisjes vendore. Bashkitë krijojnë të ardhura nga tarifatat vendore për:

- a. shërbimet publike që ato ofrojnë;
- b. të drejtën e përdorimit të pronave publike vendore;
- c. dhënien e licencave, të lejeve, autorizimeve dhe për lëshimin e dokumenteve të tjera, për të cilat ato kanë autoritet të plotë, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe me ligj;
- d. çdo tarifë tjetër të përkohshme, në përputhje me rrethanat të përcaktuara me ligj.

4.3.1 Tarifa për zënien e hapësirës publike dhe të fasadave

Njësitë e vetëqeverisjes vendore vendosin tarifa për zënien e hapësirës publike dhe të fasadave si më poshtë:

- për zënien e hapësirës në zonat publike ose para mjediseve të biznesit, për qëllime biznesi, përfshirë këtu tavolinat jashtë për bare dhe restorante;
- për përdorimin e tabelave të reklamave;
- për zënien e hapësirave të parkimit për mjetet motorike;
- për zënien e sipërfaqeve për kamping, ngritje tendash dhe mjeteve të tjera për përdorim të përkohshëm;
- për zënien e brigjeve ujore për biznes dhe qëllime të tjera;
- për mbajtjen dhe përdorimin e pajisjeve e të mjeteve të lundrimit dhe objekteve të tjera në det, lumenj ose liqene;



Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

- për mbajtjen dhe përdorimin e barkave e të platformave pluskuese, përjashtuar këtu barkat që përdoren nga organizatat e angazhuara në mirëmbajtjen dhe shënjimin e rrugëve ujore;
- për restorante dhe mjedise të tjera ushqimi dhe argëtimi pranë detit, lumenjve ose liqeneve;
- për zënie e hapësirës publike për rulotë dhe trajlerë, përveç automjeteve bujqësore dhe makinerive bujqësore;
- për zënie e hapësirës publike për mbajtjen e materialeve të ndërtimit;
- tarifa të tjera, që mund të vendosen me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Në vendosjen e këtyre e tarifave, si rregull, ndiqen kritere lidhur me vendndodhjen (zona) ku ushtrohet veprimtaria, për të cilën vendoset tarifa dhe karakteristika të tjera objektive dalluese të personave fizikë ose juridikë që zënë hapësirën publike. Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore përcakton, me vendim, nivelin e tarifave vendore, zonat dhe përdoruesit, përfshirë përjashtimet e lehtësimet, afatet dhe metodat e pagesës së tarifave.

4.3.2 Tarifa e shërbimeve publike

Tarifa e Pastrimit dhe largimit të mbetjeve

Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbetjeve zbatohet ndaj të gjitha familjeve, personave fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj që banojnë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë. Nivelet e tarifës së pastrimit dhe largimit të mbetjeve përcaktohen nga këshillat bashkiakë.

Tarifa e furnizimit me ujë

Tarifat për furnizimin me ujë i nënshtrohen të gjitha familjeve, personave fizik ose juridik, vendas ose të huaj, që banojnë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Komunës. Këto tarifa zbatohen për kategoritë e mëposhtme: furnizimi me ujë me rrjedhje të lirë, pa matës, furnizimi me ujë me matës, furnizimi me ujë me ashensor mekanik, asnjë matës dhe ujë për ujitje.

Tarifa e parkimit

Tarifa për automjetet e parkimit në parkingjet publike dhe tarifa për akomodimin e automjeteve të licencuara - taksi përcaktohet në varësi të kategorive të automjeteve (autobusë, taksi, automjete etj).

Tarifa e Shërbimit Veterinar



Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

Kjo tarifë është një pagesë fikse që zbatohet nga shërbimi veterinar për të gjitha subjektet thertore dhe tregu i gjësë së gjallë.

4.3.3 Tarifa për shërbime administrative

Këshillat e njëjësive të vetëqeverisjes vendore mund të vendosin tarifa për lëshimin e dokumenteve zyrtare nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Nëse niveli i këtyre tarifave nuk përcaktohet në ligje të tjera, këto tarifa mbulojnë kostot aktuale të shërbimit për të cilin bëhet pagesa e tarifës.

4.4 Vëzhgim i përgjithshëm mbi buxhetin e bashkive

Të ardhurat nga burimet e veta vendore¹ janë thelbësore për një qeverisje vendore të mirë dhe të pavarur. Në buxhetin vendor, kjo kategori të ardhurash përfaqësoi rreth 29.1% ndaj burimeve financiare totale në vitin 2018. Krahasuar me një vit më parë, ky raport shënoi një përmirësim të lehtë me rreth 2.3 pikë përqindjeje dhe qëndron rreth 3.1 pikë përqindjeje mbi mesataren afatgjatë.

Në këtë përmirësim vlerësohet të kenë ndikuar një sërë faktorësh, si rritja e nivelit të taksave dhe tarifave vendore në disa prej bashkive dhe përmirësimi i mundshëm në normën e mbledhjes së të ardhurave (duke përdorur si agjentë tatimorë ndërmarrjet e UK-ve). Në terma nominalë, në fund të vitit 2018 të ardhurat nga burimet e veta vendore (taksa dhe tarifa vendore, veprimtari me asete dhe të tjera) regjistruan një vlerë prej rreth 24.2 miliard lekë, në rritje me rreth 19.1% në terma vjetorë, rreth 3.9 miliard lekë më të larta nga niveli i regjistruar vitin e mëparshëm.

Të ardhurat nga taksat përfaqësojnë një burim të rëndësishëm financiar në strukturën e të ardhurave nga burimet e veta vendore. Në vitin 2018, taksat vendore kontribuan me rreth 59.7% në të ardhurat nga burimet vendore, raport ky rreth 4.8 pikë përqindjeje nën mesataren afatgjatë (prej rreth 64.5%). Në terma nominalë, të ardhurat nga taksat vendore regjistruan një nivel prej rreth 14.5 miliard lekë, në rritje me rreth 14.1% në terma vjetorë.

Më poshtë është paraqitur në mënyrë sintetike realizimi i të ardhurave vendore i bashkive pilote të Lezhës, Kukësit dhe Vaut të Dejtës.

¹ <http://financatvendore.al/pub/raporte>

Bashkia	Të ardhura totale	Totali i taksave të ndara	Totali i taksave vendore dhe tarifave	Taksa e biznesit të vogël	Taksa e fjetjes në hotel	Taksa për kalimin e pronësisë	Taksa e ndikimit në infrastrukturë	Taksa e ndërtesës	Taksa e tokës bujqësore	Taksa e truallit	Taksa e tabelës	Tarifa për shërbime administrative	Tarifa për zënie të hapësirës publike	Tarifa për shërbime publike*
Lezha	3 005 423	91 639	824 266	26 020	19 615	19 578	243 793	114 061	13 116	-	4 711	82 723	105 326	124 552
Kukës	2 325 700	36 714	220 702	4 186	-	496	1 264	50 633	26	-	4 594	42 316	33 915	80 865
Vau i Dejës	1 729 642	17 807	283 954	1 569	45	133	12 560	41 111	33 083	65	955	67 037	24 851	92 390

Tabelë: Kontributi i taksave dhe tarifave vendore në buxhetin e bashkive për vitin 2018 në mijë lekë



Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

Siç shihet nga tabela e mësipërme, bashkia e Lezhës është ajo që siguron të ardhura më të larta nga tre bashkitë pilote, kontributi i taksave dhe tarifave në të ardhurat vendore është 27% për bashkinë e Lezhës, 9% për bashkinë e Kukësit dhe 16% për bashkinë Vau i Dejës.

Sa i përket taksave lokale dhe të ardhurave nga tarifatat, në bashkinë e Lezhës, kontributi i taksës mbi ndikimin në infrastrukturë është rritur për 30%, pasuar nga taksa e ndërtesës me 14%, tarifa për zënie e hapësirës publike me 13%. Ndërkohë, në Bashkinë e Kukësit, kontributi më i madh është tarifa për shërbimet publike vendore me 37%, pasuar nga taksa mbi ndërtesën 23% dhe tarifatat e shërbimit administrativ prej 19%. Në bashkinë Vau i Dejës, kontributi kryesor është nga tarifatat për shërbime publike me 33%, pasuar nga tarifatat e shërbimit administrativ me 24% dhe taksa mbi ndërtesën me 14%. Ajo që vërehet është se bashkia Kukës nuk mblodhi të ardhura nga taksa e fjetjes në hotel dhe taksa e truallit, dhe madje edhe bashkia e Lezhës nuk e ka mbledhur taksën e truallit.

5 Modele të politikave fiskale të gjelbra në bashkitë pilote

5.1 Bashkia Lezhë

Profili i përgjithshëm

Lezha kufizohet në veri me Bashkitë e Vaut të Dejës dhe Pukës, në perëndim me Detin Adriatik, në lindje me Bashkinë e Mirditës dhe në jug me Bashkinë Kurbin. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Lezhës.

Sipas Regjistrimit Civil, kjo bashki numëron 106,245 banorë. Me një sipërfaqe prej 509.1 km², Bashkia e Lezhës ka një densitet prej 208.69 banorë/km² sipas të dhënave të Regjistrimit Civil.

Kjo bashki përbëhet nga 10 njësi administrative, të cilat janë: Lezha, Shëngjini, Zejmeni, Shënkolli, Balldreni, Kallmeti, Blinishti, Dajçi, Ungreji dhe Kolshi. Të gjitha këto njësi janë aktualisht pjesë e rrethit të Lezhës dhe e po të njëjtit qark. Bashkia ka nën administrimin e saj dy qytete (Lezhë dhe Shëngjin) dhe 65 fshatra.



Harta territoriale e bashkisë Lezhë

Aktualisht, ekonomia në qytet është e diversifikuar, por mbështetet në tregti dhe shërbime, sektorë që punësojnë numrin më të madh të banorëve të Lezhës. Vitet e fundit, industria e përpunimit të peshkut në rajonin e Lezhës ka njohur investimet më të mëdha në rang vendi, sa i përket ngritjes së stabilimenteve të peshkut.

Pozicioni i favorshëm gjeografik mundëson akses në të mirat bujqësore, të agrikulturës, blegtorisë dhe peshkimit, të cilat ndikojnë gjithashtu në potencialin ekonomik dhe rritjen e punësimit në Bashki. Megjithatë, një pjesë e territorit të Lezhës vazhdon të kërcënohet nga përmytjet, të cilat shkaktojnë herë pas here dëme të konsiderueshme.

Bashkia ka në territorin e saj qytetin e Shëngjinit dhe një vijë të gjatë bregdetare, e cila fillon nga rezervatet natyrore të mbrojtura të Bregut të Matit dhe të Kune-Vain-Tales deri te plazhet shkëmbore në veri të qytetit të Shëngjinit. Një pjesë e mirë e bregdetit nuk i ka shpëtuar betonizimit, ndërsa në këtë vijë bregdetare ka ende plazhe të virgjëra, të cilët duhen mbrojtur.

Sfida kryesore e Bashkisë së Lezhës është zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit përmes mbrojtjes së mjedisit. Për të rritur ofertën turistike për vizitorët e vet, Lezhës do t'i duhet të mbrojë dhe të promovojë trashëgiminë e pasur kulturore, historike dhe arkeologjike. Investimet në turizëm përgjatë bregdetit të Shëngjinit dhe lagunës së Kunes duhet të harmonizohen me marrjen e masave në pastrimin e vijës bregdetare dhe ndalimin e erozionit. Shtrirja e shërbimit të pastrimit në të gjithë territorin e bashkisë së re është e domosdoshme, po aq sa edhe pastrimi i grykëderdhjeve të Drinit dhe Matit nga mbeturinat.

Bashkisë i duhet të mbështesë ndërmarrjet e vogla të zejtarisë dhe produktet e traditës si dhe fuqizimin ekonomik të të rinjve, grave dhe vajzave përmes përfshirjes së tyre në sipërmarrje.

Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

Nxitja dhe lehtësirat fiskale vendore për bizneset e reja të përpunimit të prodhimeve bujqësore e blegtorale në Lezhë si dhe përmirësimi i infrastrukturës në të gjitha zonat përbën një tjetër sfidë për zhvillimin e harmonizuar të Bashkisë.

Politikat fiskale të propozuara

Bashkia e Lezhës, si pjesë e Paketës Fiskale dhe Buxhetit 2019, ka propozuar disa masa specifike për të nxitur banorët dhe bizneset në përdorim të instalimeve fotovoltaike për prodhimin e energjisë elektrike si dhe përdorimin e makinave hibride dhe elektrike si në vijim:

- Reduktim prej 30% në nivelin e taksës mbi ndërtesat për familjet dhe bizneset;
- Reduktim prej 30% në Tarifat e Shërbimeve publike për bizneset;
- Parkim falas për makinat hibride dhe elektrike në parkingjet publike;

Vlerësim i ndikimit financiar të masave fiskale

Taksa e ndërtesës

Bashkitë konsiderojnë si një burim të rëndësishëm të të ardhurave taksën e pasurisë së paluajtshme. Aktualisht Shqipëria mbledh më pak se 0.3% të PBB-së nga taksa e pronës, gjë që e bën atë dhe burimin më të ulët të të ardhurave në vendet evropiane. Megjithatë, ligji më i fundit mbi taksat vendore kërkon modernizimin e të ardhurave fiskale për bashkitë duke rritur burimin e vet të të ardhurave nga taksat e pronës së paluajtshme. Ligji i ri fiskal i miratuar në nëntor 2017 përcakton se taksa e pronës tashmë do të bazohet në vlerën e tregut.

Ky ndryshim ligjor u pasua nga miratimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 132 datë 7 mars 2018 mbi metodologjinë e vlerësimit të vlerës së tatueshme të "pasurisë së paluajtshme". Metodologjia parashikon vlerat referuese për metra katrorë për secilën bashki. Vlera e taksës është 0.05% në vit për metër katror të vlerës reale të tregut, por jo më pak se çmimi i referencës. Sipas ligjit nr. 68/2017 "Ligji për Financat Lokale", neni 12, pika 5 "Këshilli i bashkisë vendos për vlerën e taksës së pasurisë së paluajtshme +/- 30% nga një vlerë e treguar për secilën kategori".

Siç mund të shihet në Tabelën më poshtë, të ardhurat në bashkinë e Lezhës nga taksa mbi ndërtesat tregojnë një prirje të luhatshme në terma absolutë për periudhën 2016-2018. Gjithashtu, pjesa që kjo taksë zë në të ardhurat totale të mbledhura nga taksat dhe tarifatat vendore ka po ashtu luhatje për të njëjtën periudhë. Megjithatë, bashkia e Lezhës, në Programin Buxhetor Afatmesëm për 2019-2021 pret që të ardhurat nga taksa mbi ndërtesat të rriten nga 2019 e në vazhdim, si në terma nominalë ashtu edhe në ato relativë.

Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

Taksa	2016	2017	2018	2019	2020	2021
	Fakt	Fakt	Fakt	Plan	Plan	Plan
Të ardhurat nga taksa mbi ndërtesat	41,886	48,976	45,683	68,488	73,967	79,885
<i>Përqindja në të ardhura</i>	<i>13.6%</i>	<i>13.8%</i>	<i>10.6%</i>	<i>9.8%</i>	<i>10.4%</i>	<i>10.9%</i>
Të ardhura nga taksat dhe tarifatat (Total)	307,365	355,972	432,428	697,013	711,681	731,285

Tabela: Të ardhurat nga taksa e ndërtesës për periudhën 2016-2021 (në mijë LEK)

Burimi: financa.gov.al; financatvendore.al

Kjo rritje është kryesisht për shkak të zbatimit të nivelit të ri të taksës, siç u shpjegua më sipër. Dhe kjo rritje është e justifikuar nga analiza e mëposhtme.

Sipas dokumentit të buxhetit 2018 të publikuar nga Bashkia e Lezhës², numri i ndërtesave të tatueshme për qëllime banimi është 22,543, me një hapësirë mesatare prej 98 m² dhe një çmim mesatar prej 40.200 lekë. Mesatarisht, një familje do të kursente deri në 590 lekë në vit nga ky lehtësim i taksave.

Gjithashtu, numri i bizneseve që operojnë në këtë bashki është rreth 2563, me një hapësirë mesatare prej 90 m² dhe një çmim mesatar prej 60,300 lekë, 1.5 herë më i lartë se çmimi për banesa, siç përshkruhet nga metodologjia që aktualisht është në fuqi. Në këtë rast, një biznes do të kursente deri në 3,256 lekë në vit nga ky lehtësim i taksave.

Rezultatet e dhëna në tabelën më poshtë, në masë të madhe konfirmojnë vlerësimet e bashkisë së Lezhës për këtë taksë. Megjithatë, mund të ketë një diferencë gabimi prej +/- 5 deri në 10% për shkak të numrit të saktë të familjeve dhe hapësirës mesatare për secilën kategori.

Kategoritë	Nr. i ndërtesave	Niveli i ri i taksës			
		Sipërfaqja mesatare në metra katrorë	Taksa mesatare për metër katror	Niveli i taksës	Të ardhura vjetore (në LEK)
Familje	22,543	98	40,200	0.05%	44,405,201
Biznese	2,563	90	60,300	0.2%	27,818,802

² http://www.lezha.gov.al/web/projekt_buxheti_2018_dhe_pba_2018_2020_2756.pdf

Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

Total					72,224,003
--------------	--	--	--	--	-------------------

Tabela: Vlerësimi i të ardhurave nga Taksa mbi Ndërtesat me metodologjinë e re

Në llogaritjen e humbjeve potenciale nga reduktimi prej 30% e taksës së ndërtesës për familjarët dhe bizneset, vlerësimi ynë është si më poshtë:

1) Supozimi - 1% e familjeve dhe bizneseve përdorin burime të rinovueshme të energjisë

Kategoritë	Nr. i ndërtesave	Sipërfaqja mesatare në metra katrorë	Taksa mesatare për metër katror	Niveli i vjetër i taksës	Niveli i propozuar i taksës	Humbjet vjetore (në LEK)
Familje	2254	98	40,200	0.05%	0.04%	133,215
Biznese	256	90	60,300	0.2%	0.14%	83,456
Total						216,672

Tarifat e Shërbimeve Publike

Të ardhurat nga tarifat e shërbimeve publike ishin mesatarisht 11.8% të të ardhurave totale nga taksat dhe tarifat për periudhën 2016-2018 dhe Bashkia Lezhë parasheh që 2019-2021 të ruajë të njëjtën pjesë.

Tarifa	2016	2017	2018	2019	2020	2021
	Fakt	Fakt	Fakt	Plan	Plan	Plan
Të ardhura nga tarifa për shërbime publike	34,780	40,085	55,465	83,925	83,925	83,925
<i>Përqindja në të ardhura</i>	<i>11.3%</i>	<i>11.3%</i>	<i>12.8%</i>	<i>12.0%</i>	<i>11.8%</i>	<i>11.5%</i>
Të ardhura nga taksat e tarifat (Total)	307,365	355,972	432,428	697,013	711,681	731,285

Tabela: Të ardhura nga tarifa e shërbimeve publike për periudhën 2016-2021 (në mijë LEK)

Burimi: financa.gov.al; financatvendore.al

Për të vlerësuar ndikimin në buxhetin e Bashkisë së Lezhës për lehtësim të propozuar, ne kemi kryer një analizë të ngjashme të kryer mbi taksën mbi ndërtesat. Siç është parashikuar në projektbuxhetin 2018 të përgatitur nga Bashkia e Lezhës, familjet kontribuojnë deri në 62% të të ardhurave totale nga kjo tarifë, ndërsa bizneset sigurojnë 38% e mbetur. Mesatarisht, një biznes i vetëm do të fitonte deri në 2.470 lekë në baza vjetore nga lehtësimi i lartpërmendur.

Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

Siç shihet në Tabelën më poshtë, humbjet në skenarin e marrë në konsideratë janë shumë të vogla në krahasim me të ardhurat totale të pritura nga kjo tarifë, me rreth 0.07%. Nëse do të shtonim faktin se ky skenar do të donte 3 vjet ose më shumë për të materializuar, pas lehtësimit, humbjet e shkaktuara gjatë kësaj kohe do të ishin të parëndësishme.

	Nr. i bizneseve që përfitojnë nga ulja	Vlera e tarifës (në LEK)	Tarifa e reduktuar (-30%)	Humbjet vjetore (në Lek)
Supozimi (1%)	25,6	8,223	5,756	63,229

Tarifa e parkimit

Tarifa e parkingut në hapësirat publike paguhet nga të gjithë automjetet që shfrytëzojnë zonat e paracaktuara të cilat janë në pronësi të bashkisë dhe përdoren për parkim. Normat aktuale të tarifave ndryshojnë nga 50 lekë / orë për automjetet e vogla deri në 100 lekë / orë për autobusët dhe mjetet e tjera të transportit. Siç u përmend më sipër, të gjitha mjetet hibride dhe elektrike do të përfitojnë parkim falas në hapësirat publike në Bashkinë e Lezhës.

Të hyrat nga tarifat e parkimit për periudhën 2016-2018 kanë pasur një përqindje shumë të vogël kundrejt të ardhurave totale të krijuara nga taksat dhe tarifat. Bashkia e Lezhës pret që kjo pjesë të jetë edhe më e ulët në vitet 2019-2021 me një mesatare prej 0.1%. Duke pasur parasysh se numri i makinave që janë ose hibrid ose elektrik është mjaft i vogël, humbjet e mundshme në të ardhurat nga lehtësimi i tarifës së parkimit do të ishin të parëndësishme.

Tarifa	2016	2017	2018	2019	2020	2021
	Fakt	Fakt	Fakt	Plan	Plan	Plan
Të ardhura nga tarifa e parkimit	1,154	601	967	600	600	600
<i>Përqindja në të ardhura</i>	<i>0.4%</i>	<i>0.2%</i>	<i>0.2%</i>	<i>0.1%</i>	<i>0.1%</i>	<i>0.1%</i>
Të ardhura nga taksa dhe tarifa (Total)	307,36	355,97	432,42	697,01	711,68	731,28
	5	2	8	3	1	5

Tabela: Të ardhura nga tarifa e parkimit për periudhën 2016-2021 (në mijë LEK)

Vlerësimi i energjisë së kursyer dhe gazrat që nuk do të emetohen



Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

Kategoria e familjeve			
Numri i shtëpive	22,543		Burimi: Këshilli Bashkiak
1% e familjeve	225		Pra, duke qenë optimist, kemi bërë një vlerësim: 1% e familjeve marrin këtë bonus.
Fuqia e instaluar në secilën prej këtyre shtëpive	5	kW	Ne supozojmë një mesatare të fuqisë së instaluar në secilën prej shtëpive
Të dhënat e MWh vjetore për MW në Lezhë	1,487		Kjo është orari i prodhimit që një objekt në zonën e Lezhës ka në vit. Burimi: Instituti Shqiptar i Motit
Konsumi mesatar për familje në Shqipëri	8,400	kWh	
Faktor i emetimit të emetimit të energjisë elektrike për Shqipërinë	0.009	kg CO2 eq/kWh	Burimi: https://ecometrica.com/assets/Electricity-specific-emission-factors-for-grid-electricity.pdf
Ne llogarisim:	7,435	kWh/vit	
	1,672,875	kWh	kWh që bëhen të rinovueshme
	15,056	kg CO2 eq	kg CO2 eq që nuk emetohen çdo vit
Kategoria e bizneseve			
Numri i bizneseve në vitin 2018 (të mëdha dhe të vogla)	2,563		Burimi: Këshilli Bashkiak
1% e bizneseve	25		Duke qenë optimistë, kemi bërë një vlerësim: 1% e bizneseve kanë të drejtë për këtë bonus
Fuqia e instaluar	20	kW	Ne supozojmë një mesatare të fuqisë së instaluar në biznese



Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

Të dhënat e MWh vjetore për MW në Lezhë	1,487		Kjo është orari i prodhimit që një objekt në zonën e Lezhës ka në vit. Burimi: Instituti Shqiptar i Motit
Faktor i emetimit të emetimit të energjisë elektrike për Shqipërinë	0.009	kg CO2 eq/kWh	https://ecometrica.com/assets/Electricity-specific-emission-factors-for-grid-electricity.pdf
Ne llogarisim:	29,740	kWh/vit	
	743,500	kWh	kWh që bëhen të rinovueshme
	6,692	kg CO2 eq	Kg Co2 që nuk emetohen çdo vit
Automjetet			
Konsumi mesatar i një automjeti me djegie	143	g CO2/km	
Konsumi mesatar i një automjeti elektrik	60	g CO2/km	Burimi. Agjencia Evropiane e Mjedisit
Udhëtimi me makinë	7,000	km/vit	supozim
Numri i makinave për 1000 banorë	175		http://www.instat.gov.al/media/3595/vjetari-statistikor-rajonar-shqip-2017-dt13112017.pdf
Numri i makinave	18,500		http://www.instat.gov.al/media/3595/vjetari-statistikor-rajonar-shqip-2017-dt13112017.pdf
1% e makinave të pasagjerëve	185		Vlerësojmë se 1% e makinave të pasagjerëve janë elektrike.
Ne llogarisim:			Automjetet me motor me djegie
	2,645,500	g/km CO2	
	18,518,500,000	g/km CO2 / vit	

Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

	18,519	t/km CO2 / vit	g / km CO2 të emetuar nga automjetet elektrike
	11,100	g/km CO2	
	77,700,000	g/km CO2 / vit	
	77.7	t/km CO2 / vit	
Vlerësojmë se 1% e makinave të pasagjerëve janë elektrike.	2,619,045.0	g/km CO2	
	18,333,315,000	g/km CO2 / vit	
	18,333	t/km CO2 / vit	që nuk do të emetohen
	185	t/km CO2 / vit	që nuk do të emetohen
Duke marrë parasysh emetimet që rrjedhin nga konsumi elektrik i makinës elektrike	107	t/km CO2 / vit	g / km CO2 të emetuar nga automjetet elektrike

5.2 Bashkia Vau i Dejës

Profili i përgjithshëm

Bashkia Vau i Dejës kufizohet në veri dhe në perëndim me bashkinë e Shkodrës, në lindje me bashkinë Fushë Arrëz ndërsa në jug me bashkitë Pukë dhe Lezhë. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Vaut të Dejës.

Sipas Regjistrimit Civil, kjo bashki numëron 48,966 banorë. Bashkia ka në një sipërfaqe prej 499.09 km² me një densitet prej 98.11 banorë/km². Kjo bashki përbëhet nga 6 njësi administrative, të cilat janë: Vau Dejës, Bushat, Vig-Mnele, Hajmel, Temal, Shllak. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Shkodrës dhe pjesë e po këtij qarku. Bashkia ka nën administrimin e saj një qytet dhe 47 fshatra.

Bashkia e Vaut të Dejës ka 5 njësi administrative, të cilat merren kryesisht me bujqësi, ndërsa zona ka resurse të konsiderueshme ujore. Në të ndodhet hidrocentrali i Vaut të Dejës si dhe HEC-et Ashta 1 dhe Ashta 2, të ndërtuara me koncesion privat gjatë viteve të fundit.



Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

Komuna e Bushatit është një zonë e njohur për prodhimet bujqësore dhe ka një aktivitet jo të vogël në eksportin e zarzavateve. Nga ana tjetër, Komunitat Shllak dhe Temal gjenden në anën tjetër të liqenit të Vaut të Dejës dhe pa lidhje historike me bashkinë e re. Këto dy komuna janë veçanërisht të varfra me tokë për shkak se një pjesë e konsiderueshme e tyre është përmbytur nga liqeni i Vaut të Dejës.

Para viteve 90, shumica e banorëve në Vaun e Dejës punonin në hidrocentral, në fabrikën e bakrit si dhe në kooperativa bujqësore. Ndërkohë që zhvillimi ekonomik aktual mbështetet kryesisht në bizneset e vogla të shërbimit, të cilat janë të pozicionuara kryesisht në qytetin Vau e Dejës.

Niveli i papunësisë është i lartë, ndaj edhe një pjesë e madhe e popullsisë gjendet në emigrim, kryesisht në shtetet e Italisë dhe Greqisë. E veçantë për këtë bashki është ekzistenca e sipërfaqeve të konsiderueshme ujore, ku dominon liqeni i Hidrocentralit të Vaut të Dejës, lumi Drin që vazhdon në shtratin e tij të vjetër që nga pengesa e digës së Hidrocentralit si dhe lumi Gjadër që shpëputet nga lumi i parë, rreth 1 km në juglindje të qytetit të Vaut të Dejës. Pasuria e madhe ujore e bën gjithashtu zonën të prekur nga përmbytjet.

Zhvillimi i turizmit natyror është një mundësi e rritjes ekonomike të kësaj zone, pasi në liqenin e Vaut të Dejës gjenden kështjella dhe kisha ndër më të vjetrat në Ballkan, të cilat ende sot mbartin vlera historike dhe arkeologjike. Liqeni i Vaut të Dejës mund të kthehet gjithashtu në një burim të rëndësishëm turistik, në rast se rikthehet transporti për qëllime turistike nga Vau i Dejës deri në Koman.

Evitimi i përmbytjeve mbetet një nga sfidat kryesore të kësaj bashkie, nëpërmjet investimeve në kanalet kulluese dhe vaditëse, por edhe ndërtimin e argjinaturave përgjatë brigjeve të lumenjve.

Ekzistenca e industrisë energjetike mund të vendosen në një kontekst të tillë përdorimi dhe menaxhimi në favor të rritjes ekonomike dhe zhvillimit të bashkisë Vau i Dejës.

Zona etnografike e Zadrimës, e cila shtrihet pjesërisht në bashkinë e Lezhës dhe pjesërisht në Vaun e Dejës është e njohur për zhvillimin e vreshtarisë, aftësive drejtuese në ndërmarrjet bujqësore familjare dhe në zhvillimin e agro-turizmit. Mbetet sfidë mbështetja e këtyre bizneseve nga pushteti vendor dhe nxitja e mëtejshme e kooperimit në bujqësi.



Harta e re territoriale e bashkisë Vau i Dejës

Zhvillimi i rrjetit eko-kulturor në Liqenin e Vaut të Dejës dhe përgjatë Zadrimes, përmes një projekti të qartë do të ndikonte në shtimin e të ardhurave. Bashkia e re do të duhet të gjejë rrugë të reja si mundësi të hapjes së njësive të fasonëve apo njësive të vogla të prodhimeve artizanale për punësimin e banorëve të zonës.

Zgjidhja e çështjeve të pronësisë vazhdon të mbetet një problem për drejtuesit vendorë, po aq sa edhe sigurimi i tregjeve për produktet bujqësore. Ofrimi i shërbimeve publike për dy komunat matanë liqenit të Vaut të Dejës konsiderohet gjithashtu sfidë për bashkisë së re, e cila duhet të sigurojë më së pari infrastrukturën rrugore për lidhjen e këtyre komunave me qytetin.

Politikat fiskale të propozuara

Bashkia e Vaut të Dejës, si pjesë e Paketës Fiskale dhe Buxhetit 2019, ka propozuar disa masa specifike për të nxitur banorët dhe bizneset në përdorim të instalimeve fotovoltaike për prodhimin e energjisë elektrike si në vijim:

- Reduktim prej 30% në nivelin e taksës mbi ndërtesat për familjet dhe bizneset;
- Reduktim prej 30% në Tarifat e Shërbimeve publike për bizneset;

Taksa e ndërtesës

Bashkitë konsiderojnë si një burim të rëndësishëm të të ardhurave taksën e pasurisë së paluajtshme. Aktualisht Shqipëria mblend më pak se 0.3% të PBB-së nga taksa e pronës, gjë që e bën atë dhe burimin më të ulët të të ardhurave në vendet evropiane. Megjithatë, ligji më i fundit mbi taksat vendore kërkon

Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

modernizimin e të ardhurave fiskale përbashkitë duke rritur burimin e vet të të ardhurave nga taksat e pronës së paluajtshme. Ligji i ri fiskal i miratuar në nëntor 2017 përcakton se taksa e pronës tashmë do të bazohet në vlerën e tregut.

Ky ndryshim ligjor u pasua nga miratimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 132 datë 7 mars 2018 mbi metodologjinë e vlerësimit të vlerës së tatueshme të "pasurisë së paluajtshme". Metodologjia parashikon vlerat referuese për metra katrorë për secilën bashki. Vlera e taksës është 0.05% në vit për metër katror të vlerës reale të tregut, por jo më pak se çmimi i referencës. Sipas ligjit nr. 68/2017 "Ligji për Financat Lokale", neni 12, pika 5 "Këshilli i bashkisë vendos për vlerën e taksës së pasurisë së paluajtshme +/- 30% nga një vlerë e treguar për secilën kategori".

Siç mund të shihet në Tabelën më poshtë, të ardhurat në bashkinë e Vaut të Dejës nga taksa mbi ndërtesat tregojnë një prirje të luhatshme në terma absolutë për periudhën 2016-2018. Gjithashtu, pjesa që kjo taksë zë në të ardhurat totale të mbledhura nga taksat dhe tarifatat vendore ka po ashtu luhatje për të njëjtën periudhë. Megjithatë, bashkia në Programin Buxhetor Afatmesëm për 2019-2021 pret që të ardhurat nga taksa mbi ndërtesat të rriten nga 2019 e në vazhdim, si në terma nominalë ashtu edhe në ato relativë.

Taksa	2016	2017	2018	2019	2020	2021
	Fakt	Fakt	Fakt	Plan	Plan	Plan
Të ardhurat nga taksa mbi ndërtesat	13,540	10,403	23,000	29,550	31,800	32,600
<i>Përqindja në të ardhura</i>	11.9%	12.6%	18.2%	18.1%	18.3%	17.4%
Të ardhura nga taksat dhe tarifatat (Total)	114,174	82,515	126,452	163,175	174,115	187,095

Tabela: Të ardhurat nga taksa e ndërtesës për periudhën 2016-2021 (në mijë LEK)

Burimi: financa.gov.al; financatvendore.al

Kjo rritje është kryesisht për shkak të zbatimit të nivelit të ri të taksës, siç u shpjegua më sipër. Dhe kjo rritje është e justifikuar nga analiza e mëposhtme.

Sipas dokumentit të buxhetit 2018 të publikuar nga Bashkia Vau i Dejës³, numri i ndërtesave të tatueshme për qëllime banimi është 22,543, me një hapësirë mesatare prej 98 m² dhe një çmim mesatar prej 40.200 lekë. Mesatarisht, një familje do të kursente deri në 590 lekë në vit nga ky lehtësim i taksave.

³ http://www.Vau-Dejës.gov.al/web/projekt_buxheti_2018_dhe_pba_2018_2020_2756.pdf



Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

Gjithashtu, numri i bizneseve që operojnë në këtë bashki është rreth 2563, me një hapësirë mesatare prej 90 m² dhe një çmim mesatar prej 60,300 lekë, 1.5 herë më i lartë se çmimi për banesa, siç përshkruhet nga metodologjia që aktualisht është në fuqi. Në këtë rast, një biznes do të kursente deri në 3,256 lekë në vit nga ky lehtësim i taksave.

Rezultatet e dhëna në tabelën më poshtë, në masë të madhe konfirmojnë vlerësimet e bashkisë së Lezhës për këtë taksë. Megjithatë, mund të ketë një diferencë gabimi prej +/- 5 deri në 10% për shkak të numrit të saktë të familjeve dhe hapësirës mesatare për secilën kategori.

Kategoritë	Nr. i ndërtesave	Niveli i ri i taksës			
		Sipërfaqja mesatare në metra katrorë	Taksa mesatare për metër katror	Niveli i taksës	Të ardhura vjetore (në LEK)
Familje	22,543	98	40,200	0.05%	44,405,201
Biznese	2,563	90	60,300	0.2%	27,818,802
Total					72,224,003

Tabela: Vlerësimi i të ardhurave nga Taksa mbi Ndërtesat me metodologjinë e re

Në llogaritjen e humbjeve potenciale nga reduktimi prej 30% e taksës së ndërtesës për familjarët dhe bizneset, vlerësimi ynë është si më poshtë:

2) Supozimi - 1% e familjeve dhe bizneseve përdorin burime të rinovueshme të energjisë

Kategoritë	Nr. i ndërtesave	Sipërfaqja mesatare në metra katrorë	Taksa mesatare për metër katror	Niveli i vjetër i taksës	Niveli i propozuar i taksës	Humbjet vjetore (në LEK)
Familje	121	98	24,300	0.05%	0.04%	43,211
Biznese	57	110	36,450	0.20%	0.14%	13,760
Total						56,972

Tarifat e Shërbimeve Publike

Të ardhurat nga tarifatat e shërbimeve publike në raport me të ardhurat totale nga taksat dhe tarifatat për periudhën 2016-2018 paraqitet më poshtë dhe Bashkia Vau i Dejës parasheh që 2019-2021 të ruajë të njëjtën pjesë.

Tarifa	2016	2017	2018	2019	2020	2021
	Fakt	Fakt	Fakt	Plan	Plan	Plan
Të ardhura nga tarifa për shërbime publike	28,166	25,544	37,149	32,220	33,550	34,720
<i>Përqindja në të ardhura</i>	24.7%	31.0%	29.4%	19.7%	19.3%	18.6%
Të ardhura nga taksat e tarifatat (Total)	114,174	82,515	126,452	163,175	174,115	187,095

Tabela: Të ardhura nga tarifa e shërbimeve publike për periudhën 2016-2021 (në mijë LEK)

Burimi: financa.gov.al; financatvendore.al

Për të vlerësuar ndikimin në buxhetin e Bashkisë së Vaut të Dejës për lehtësim të propozuar, ne kemi kryer një analizë të ngjashme të kryer mbi taksën mbi ndërtesat. Siç është parashikuar në projektbuxhetin 2018 të përgatitur nga Bashkia e Lezhës, familjet kontribuojnë deri në 34% të të ardhurave totale nga kjo tarifë, ndërsa bizneset sigurojnë 66% e mbetur.

Siç shihet në Tabelën më poshtë, humbjet në skenarin e marrë në konsideratë janë shumë të vogla në krahasim me të ardhurat totale të pritura nga kjo tarifë. Nëse do të shtonim faktin se ky skenar do të donte 3 vjet ose më shumë për të materializuar, pas lehtësimit, humbjet e shkaktuara gjatë kësaj kohe do të ishin të parëndësishme.

	Nr. i bizneseve që përfitojnë nga ulja	Vlera e tarifës (në LEK)	Tarifa e reduktuar (-30%)	Humbjet vjetore (në Lek)
Supozimi (1%)	5,7	42,462	29,723	72,864

Vlerësimi i energjisë së kursyer dhe gazrat që nuk do të emetohen



Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

Kategoria e familjeve			
Numri i shtëpive	12,097		Burimi: Këshilli Bashkiak
1% e familjeve	120		Pra, duke qenë optimist, kemi bërë një vlerësim: 1% e familjeve marrin këtë bonus.
Fuqia e instaluar në secilën prej këtyre shtëpive	5	kW	Ne supozojmë një mesatare të fuqisë së instaluar në secilën prej shtëpive
Të dhënat e MWh vjetore për MË në Vau i Dejës	1,426		Kjo është orari i prodhimit që një objekt në zonën e Vaut të Dejes ka në vit. Burimi: Instituti Shqiptar i Motit
Konsumi mesatar për familje në Shqipëri	8,400	kWh	
Faktor i emetimit të emetimit të energjisë elektrike për Shqipërinë	0.009	kg CO2 eq/kWh	Burimi: https://ecometrica.com/assets/Electricity-specific-emission-factors-for-grid-electricity.pdf
Ne llogarisim:	7,130	kWh/vit	
	855,600	kWh	kWh që bëhen të rinovueshme
	7,700	kg CO2 eq	kg CO2 eq që nuk emetohen çdo vit
Kategoria e bizneseve			
Numri i bizneseve në vitin 2018 (të mëdha dhe të vogla)	572		Burimi: Këshilli Bashkiak
1% e bizneseve	5.7		Duke qenë optimistë, kemi bërë një vlerësim: 1% e bizneseve kanë të drejtë për këtë bonus
Fuqia e instaluar	20	kW	Ne supozojmë një mesatare të fuqisë së instaluar në biznese

Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

Të dhënat e MWh vjetore për MW në Vau i Dejës	1,426		Kjo është orari i prodhimit që një objekt në zonën e Vau te Dejës ka në vit. Burimi: Instituti Shqiptar i Motit
Faktor i emetimit të emetimit të energjisë elektrike për Shqipërinë	0.009	kg CO2 eq/kWh	https://ecometrica.com/assets/Electricity-specific-emission-factors-for-grid-electricity.pdf
Ne llogarisim:	28,520	kWh/vit	
	162,564	kWh	kWh që bëhen të rinovueshme
	1,463	kg CO2 eq	Kg Co2 që nuk emetohen çdo vit

5.3 Bashkia Kukës

Profil i Përgjithshëm

Kukësi kufizohet në veri me Bashkinë Krumë, në perëndim me bashkitë Mirditë dhe Fushë-Arrëz, në jug me Bashkinë Dibër dhe në lindje me Republikën e Kosovës dhe me atë të Maqedonisë. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Kukësit.

Sipas Regjistrimit Civil, kjo bashki ka 59,393 banorë. Bashkia ka një sipërfaqe prej 933.86 km² me një densitet prej 63.59 banorë/km² sipas Regjistrimit Civil. Kjo bashki përbëhet nga 15 njësi administrative, të cilat janë: Kukësi, Malzi, Bicaj, Ujmisht, Tërthore, Shtiqën, Zapod, Shishtavec, Topojan, Bushtricë, Grykë-Çajë, Kalis, Surroj, Arrën dhe Kolsh. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit Kukës dhe pjesë e po këtij qarku. Bashkia ka nën administrimin e saj një qytet dhe 87 fshatra.

Kukësi ishte një qendër industriale gjatë regjimit komunist në Shqipëri. Deri në vitet '90, Kukësi kishte industri të nxjerrjes dhe shkrirjes së bakrit (teknologji sovjetike e viteve '60), nxjerrjes dhe koncentrimit të mineralit të kromit, nxjerrjes së mineralit të kuarcit, prodhimit të materialeve të ndërtimit (materiale inerte, parafabrikate etj). Ai njihet si një vend me traditë në rritjen dhe mbarështimin e deleve. Cilësia e mishit dhe e leshit të deleve lumjane ishte e njohur në të gjithë Ballkanin. Kukësi ishte gjithashtu një qendër e njohur e transportit. Krahas llojeve të tjera të transportit, aty ishte i zhvilluar dhe transporti ujqor përmes liqenit artificial të Fierzës, i cili bënte të mundur lëvizjen e mallrave dhe të udhëtarëve si dhe zhvillimin e turizmit. Që prej vitit 2000, transporti përmes Liqenit të Fierzës ka pushuar së ekzistuari.

Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

Një pjesë e konsiderueshme e banorëve të qytetit dhe të fshatrave punonin në zonën nxjerrëse dhe përpunuese të kromit në Kalimash si dhe në minierën e nxjerrjes së bakrit në Gjegjan. Transformimet e domosdoshme ekonomike drejt tregut të lirë pas viteve '90 bënë që pjesa më e madhe e industrisë së lartpërmendur të falimentojë tërësisht, sepse ajo industri ishte ngritur për të funksionuar në kushtet e një ekonomie të centralizuar. Mirëpo kjo shkaktoi shumë plagë sociale, duke krijuar një numër të madh të papunësh. Moszgjidhja në kohë e problemeve të pronësisë mbi tokën (veçmas problemeve të mbartura, të krijuara nga shpërngulja e detyrueshme e banorëve të Kukësit të Vjetër pas ndërtimit të HEC-it të Fierzës) shkaktuan shumë konflikte pronësie dhe bllokuan tërësisht nismat e biznesit vendas dhe atij të huaj, duke krijuar një ngërç absurd që ende sot e kësaj dite vazhdon të mbajë nën tension shumë prej banorëve të Kukësit.



Harta territoriale Kukës

Kukësi ka probleme mjedisore dhe sfida të shumta zhvillimore. Pjesa më e madhe e 87 fshatrave të bashkisë së re nuk janë ende të lidhura me rrugë të asfaltuar, ndërsa rrugët e paasfaltuara janë të degraduara, duke krijuar distancë të konsiderueshme mes qytetit të Kukësit dhe fshatrave të zonave të thella malore si Arrën apo Kalis.

Zhvillimi i liqenit të Kukësit si resurs turistik apo për peshkim kërkon gjithashtu krijimin e një sistemi të peshkëzimit vjetor. Po kaq problem janë edhe ujërat e zeza të qytetit të Kukësit, të cilat aktualisht derdhen drejtpërsëdrejti në liqenin e Fierzës, duke dëmtuar mjedisin. Rajoni i Kukësit mund të zhvillojë delen e llojit Rudë, e cila është karakteristike për këtë zonë.

Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

Menaxhimi i burimeve minerare të zonës në shërbim të komunitetit është një sfidë tjetër, pasi sistemi aktual i fragmentarizuar i lejeve të shfrytëzimit të burimeve natyrore ka sjellë dëme mjedisore, përveç keqpërdorimit të këtyre burimeve.

Kukësi është përpjekur aktualisht të rrisë kapacitetet njerëzore për të aplikuar dhe përfituar fonde nga Instrumenti i Para-Anëtarësimit (IPA) i Bashkimit Europian.

Politikat fiskale të propozuara

Bashkia e Kukësit, si pjesë e Paketës Fiskale dhe Buxhetit 2019, ka propozuar disa masa specifike për të nxitur banorët dhe bizneset në përdorim të instalimeve fotovoltaike për prodhimin e energjisë elektrike si në vijim:

- Ulja e Tarifës së Gjellbërimit me 30% për ato familje, institucione dhe biznese që kanë instaluar një pajisje fotovoltaike në ambientet e tyre. Kategoria e bizneseve të transportit (përveç atyre që kanë zyra të përhershme) nuk mund të përfshihen në këtë politikë fiskale pasi nuk kanë struktura të përhershme (ndërtesa) për të instaluar panele diellore.

Tarifat e Shërbimeve Publike

Tabela e Tarifës së Gjellbërimit aktuale të miratuar nga Këshilli Bashkiak

Nr	Kategori	Niveli i Tarifës
I	Familjarë	
I.1	Qyteti Kukës	300
I.2	Njësitë e tjera administrative	200
II	Institucionet	5000
III.	Bizneset	
III.1	Me pakicë	3000
III.2	Me shumicë	5000
III.3	Karburantet	5000
III.4	Profesione të tjera	5000
III.5	Pika me shumicë me disa aktivitete	10000



Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

III.6	Njësi prodhimi	
	Të vogla	3000
	Të mëdha	5000
III.9	Transport	2000
III.10	Ndërtim	5000

Pas miratimit paketa fiskale për Bashkinë e Kukësit do të ndryshohet si më poshtë për kategoritë e mëposhtme të Tatimpaguesve:

Tabela e Tarifës së Gjellbërimit për tu miratuar nga Këshilli Bashkiak

Nr	Kategori	Niveli i Tarifës
I	Familjarë	
I.1	Qyteti Kukës	210
I.2	Njësitë e tjera administrative	140
II	Institucionet	3500
III.	Bizneset	
III.1	Me pakicë	2100
III.2	Me shumicë	3500
III.3	Karburantet	3500
III.4	Profesione të tjera	3500
III.5	Pika me shumicë me disa aktivitete	7000
III.6	Njësi prodhimi	
	Të vogla	2100
	Të mëdha	3500
III.9	Transport	1400



Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

III.10	Ndërtim	3500
--------	---------	------

	Supozimi (1%)	Vlera e tarifës (në LEK)	Tarifa e reduktuar (-30%)	Humbjet vjetore (në Lek)
Nr. i bizneseve që përfitojnë nga ulja	9	3000	2100	8100
Nr. i familjeve që përfitojnë nga ulja	95	300	210	8550
TOTAL				16650

Vlerësimi i energjisë së kursyer dhe gazrat që nuk do të çlirohen

Kategoria e familjeve			
Numri i shtëpive	9,597		Burimi: Këshilli Bashkiak
1% e familjeve	95		Pra, duke qenë optimist, kemi bërë një vlerësim: 1% e familjeve marrin këtë bonus.
Fuqia e instaluar në secilën prej këtyre shtëpive	5	kW	Ne supozojmë një mesatare të fuqisë së instaluar në secilën prej shtëpive
Të dhënat e MWh vjetore për MW në Kukës	1,328		Kjo është orari i prodhimit që një objekt në zonën e Kukësit ka në vit. Burimi: Instituti Shqiptar i Motit
Konsumi mesatar për familje në Shqipëri	8,400	kWh	
Faktor i emetimit të emetimit të energjisë elektrike për Shqipërinë	0.009	kg CO2 eq/kWh	Burimi: https://ecometrica.com/assets/Electricity-specific-emission-factors-for-grid-electricity.pdf



Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

Ne llogarisim:	6,640	kWh/vit	
	630,800	kWh	kWh që bëhen të rinovueshme
	5,677	kg CO2 eq	kg CO2 eq që nuk emetohen çdo vit
Kategoria e bizneseve			
Numri i bizneseve në vitin 2018 (të mëdha dhe të vogla)	911		Burimi: Këshilli Bashkiak
1% e bizneseve	9		Duke qenë optimistë, kemi bërë një vlerësim: 1% e bizneseve kanë të drejtë për këtë bonus
Fuqia e instaluar	20	kW	Ne supozojmë një mesatare të fuqisë së instaluar në biznese
Të dhënat e MWh vjetore për MW në Kukës	1,328		Kjo është orari i prodhimit që një objekt në zonën e Kukësit ka në vit. Burimi: Instituti Shqiptar i Motit
Faktor i emetimit të emetimit të energjisë elektrike për Shqipërinë	0.009	kg CO2 eq/kWh	https://ecometrica.com/assets/Electricity-specific-emission-factors-for-grid-electricity.pdf
Ne llogarisim:	26,560	kWh/vit	
	239,040	kWh	kWh që bëhen të rinovueshme
	2,151	kg CO2 eq	Kg Co2 që nuk emetohen çdo vit

6 Mjetet e verifikimit për kategoritë përfituese

Identifikimi i kategorive të tatimpaguesve (familjeve dhe bizneseve) do të përfshijë hapat e mëposhtëm:

Për uljen e Taksës së Pronës (ndërtesë)



Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

Drejtoria e Tarifave dhe Taksave është përgjegjëse për zbatimin e politikës fiskale. Ajo është përgjegjëse për identifikimin e subjekteve përfituese dhe llogaritjen e nivelit të ri që duhet paguar për taksën e pronës (ndërtesë).

Identifikimi i subjekteve do të kryhet në një proces me dy hapa:

- a. Vetëdeklarimi i tatimpaguesve në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave për instalimin e strukturave fotovoltaike. Kjo mund të bëhet me faturat e blerjes së këtyre instalimeve. Blerësi në faturë duhet të jetë i njëjtë me subjektin që kërkon lirim nga taksat. Nëse një faturë e tillë nuk ekziston, fotot ose ndonjë dokument tjetër për të vërtetuar ekzistencën e një instalimi fotovoltaike do t'i paraqitet zyrës së taksave.
- b. Verifikimi në vend i inspektorëve të taksave bashkiake do të kryhet kur shihet e nevojshme nga zyrtari përgjegjës. Verifikimi do të kryhet nga një grup prej tre punonjësish (zyra e taksave, departamenti i planifikimit urban dhe i shërbimeve publike).

Për lehtësim në tarifën e shërbimeve publike:

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave janë përgjegjëse për zbatimin e politikës fiskale. Ato janë përgjegjëse për identifikimin e subjekteve përfituese dhe llogaritjen e nivelit të ri që duhet paguar për tarifën e shërbimeve publike.

Identifikimi i subjekteve do të kryhet në një proces me dy hapa:

- a. Vetëdeklarimi i tatimpaguesve në Drejtorinë e Shërbimeve Publike për instalimin e strukturave fotovoltaike. Kjo mund të bëhet me faturat e blerjes së këtyre instalimeve. Blerësi në faturë duhet të jetë i njëjtë me subjektin që kërkon lirim nga taksat. Nëse një faturë e tillë nuk ekziston, fotot ose ndonjë dokument tjetër për të vërtetuar ekzistencën e një instalimi fotovoltaike do t'i paraqitet zyrës përkatëse. Departamenti i Shërbimeve Publike do të hartojë dhe përditësojë listën e këtyre lëndëve dhe do ta dërgojë atë në Departamentin e Taksave.
- b. Verifikimi në vend i inspektorëve të taksave do të kryhet kur shihet e nevojshme nga zyrtari përgjegjës. Verifikimi do të kryhet nga një grup prej tre punonjësve (zyra e taksave, departamenti i planifikimit urban dhe i shërbimeve publike).

Për parkim falas në hapësirat publike

Drejtoria e Shërbimeve është zyra përgjegjëse në zbatimin e kësaj politike fiskale. Verifikimi i subjekteve që përfitojnë dy orë parkim të lirë në hapësirat publike do të bëhet në vend nga punonjësit përkatës.

7 Komunikimi me Komunitetin

Politikat fiskale të paraqitura në këtë propozim do të përfshihen në procesin e përgatitjes së projektbuxhetit për vitin e ardhshëm 2019. Bashkia do të mbajë seanca konsultimi me komunitetin, si pjesë e buxhetit 2019.

Si çdo akt i miratuar nga këshilli bashkiak, këto politika fiskale do të publikohen në faqen e saj zyrtare dhe do të shfaqen në vende publike të caktuara për këtë qëllim informimin e publikut brenda territorit të njësisë vendore dhe kur është e mundur, këshilli bashkiak do të përdorë të tjera format e publikimit të tyre. Në çdo bashki, qytetarët duhet të informohen në përputhje me Ligjin për Informimin dhe rregullat e vendosura nga këshilli bashkiak për këtë qëllim.

8 Përfundime

Edhe pse politika e lehtësimit të taksave dhe taksave lokale të ndërmarrë në bashkitë pilote siguron një hap të rëndësishëm drejt përqaftimit të prodhimit të energjisë së gjelbër nga bashkitë e tjera, Projekti është plotësisht i vetëdijshëm se këto masa nuk do të mjaftojnë për të arritur një përdorim të plotë të energjitë e rinovueshme që zotëron Shqipëria. Shpenzimet e blerjes së këtyre pajisjeve do të përbënin një pengesë të madhe për familjet me të ardhura të ulëta dhe të mesme, si dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Si i tillë, një qasje e koordinuar me qeverinë qendrore është shumë e nevojshme për të eksploruar mundësitë më të mira për të bërë investime në këto teknologji të përballeshme për të gjitha pjesët e popullsisë dhe bizneseve. Subvencionet e qeverisë, garancitë e huave, subvencionet e normës së interesit mund të jenë disa opsione efektive që mund të jenë efektive në shtrirjen e përdorimit të pajisjeve të ripërtëritshme të energjisë. Kjo duhet të shoqërohet me një fushatë të gjerë ndërgjegjësimi të drejtuar nga qeveria qendrore dhe ajo lokale duhet të planifikohet dhe të kryhet në mënyrë që të informojë qytetarët dhe bizneset për kostot dhe përfitimet e përdorimit të këtyre llojeve të pajisjeve. Kjo do të përshpejtonte procesin e kalimit në burimet e ripërtëritshme të energjisë, pasi qytetarët do të ishin plotësisht të vetëdijshëm për përfitimet e ngushta (më pak shpenzime për energji për familjet dhe bizneset) si dhe përfitime më të gjera (më pak ndotje dhe cilësi më të mirë mjedisore).

Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

Për më tepër, masat e propozuara fiskale si dhe mekanizmat e tjerë novatorë financiarë mund të zgjerohen për të adresuar masat e tjera të efikasitetit të energjisë të cilat mund të futen lehtë si: izolimi termik i ndërtesave familjare dhe të biznesit, panele diellore për ujë të nxehtë, energji eolike etj. , Bashkia e Tiranës ka gëzuar një zbatim mjaft të suksesshëm të programit të saj të quajtur "Fondi i Komunitetit", në të cilin inkurajon komunitetet e vogla që të investojnë bashkë me Bashkinë e Tiranës, në 50-50 vjet, në projekte që synojnë termoizolimin e saj si dhe instalimin e paneleve diellore për energji elektrike ose për qëllime të ujit të nxehtë.

Së fundi, gjatë horizontit afatgjatë, qeveria shqiptare duhet të investojë në sektorin e shpërndarjes së energjisë me teknologjitë e nevojshme që lehtë lejojnë kalimin e energjisë elektrike nga pajisjet fotovoltaike të familjeve dhe bizneseve në rrjet, në kohën kur energjia elektrike e prodhuar nga këto pajisje është duke tejkaluar kërkesën ditore. Kjo masë do të ishte edhe më tërheqëse për familjet dhe bizneset, pasi ata do të përfitonin edhe më shumë nga pikëpamja financiare duke shitur energjinë elektrike tek Autoriteti i Shpërndarjes së Energjisë dhe të jenë në gjendje të investojnë në një shkallë shumë më të madhe në këto teknologji, duke pasur parasysh mundësitë e krijuara të tregut.